3 herën e dytë, domethënë, brenda një nate, kjo është, domethënë
4 ose qatë natë e kanë marrë herën e dytë ose e kanë marrë të
5 nesërmen edhe më nuk e kemi parë asnjëherë.

6 Kjo është ajo përgjigja që mund të jap nga ajo që më
7 kujtohet. Jo në bazë të thashethemeve, po unë çka kam parë
8 vetë.

9 Py. E pe këtë person, këtë viktimë të rrahur keq që e kishte
10 atë pamjen siç e përshkrove. Çfarë efekti pati tek ty dhe tek
11 të ndaluarit e tjerë pamja e tij?

12 Pë. Tek ne krijoi përshtypjen që ne jemi në gjendje kritike
13 për veten tonë, secili prej neve edhe mund të na ndodhte
14 njësoj. Ashtu e kuptova unë.

15 Py. A patët frikë kur jua treguan -- ti vetë faktikisht, a
16 pate frikë kur ta treguan këtë viktimë?

17 Pë. Frikë aty se ne kemi qenë të paarmatosur edhe ne nuk
18 dinim arsyen pse jemi aty. Arsyen e saktë pse jemi aty. Të
19 gjitha ato arsye të tjera që kanë thënë ata janë të
20 palogjikshme për neve kanë qenë, a kupton.

21 Py. The, se ky person, kjo viktimë e maltratuuar aq keq i
22 kishte [REDAKTUAR]. Po ti dhe ata dy personat e tjerë që
23 të mbanin aty në haur i kishit edhe ju [REDAKTUAR]

24 Pë. Jo, asnjëherë ne si kemi pasë. [REDAKTUAR]

25 [REDAKTUAR]

1 [REDAKTUAR]

2 [REDAKTUAR]

3 [REDAKTUAR]

4 [REDAKTUAR]

5 [REDAKTUAR]

6 Po ashtu ata kanë qenë të armatosur edhe neve p.sh., kur
7 kishim nevojë me shku në tualet - po flas për vete, se asnjëri
8 nuk na kanë dërgue në tualet së bashku po një nga një - mu për
9 vete një person më armë revole në dorë mbrapa shpinës më rrike
10 në distancë një metër larg e të kthyer revolen nga unë, derisa
11 kam hyrë në tualet, se ka qenë një tualet jashtë vendit ku
12 neve qëndrojshim. U dukke me i tregu atyne që "po do me shku
13 në tualet" ai na merrke, na dërgojke për një dere ecshim nja
14 15 metra 20 edhe ishim në një tualet që ka qenë i ndarë prej
15 objektit.

16 Ai që ka qenë me armë në dorë, ka qenë, më kujtohet,

17 [REDAKTUAR]

18 [REDAKTUAR]

19 [REDAKTUAR]

20 [REDAKTUAR]

21 [REDAKTUAR] kam marrë vesh ma vonë, domethënë, e

22 kam marrë vesh pastaj.

23 Py. Ky person që ju shoqëronte në tualet jashtë, si ishte i
24 veshur ky personi, të kujtohet?

25 Pë. Ky personi që ka qenë në tualet që më përcillke, ka qenë

1 i veshur me një pjesë ushtarake, tjerat rroba civile i ka
2 pasë. Vetëm herë e ka pasë një pjesë ushtarake herë jo, një të
3 zezë, një jakne kështu. Edhe pantollat herë i vishke
4 ushtarake, herë i vishke civile varet qysh i ka kanë pasë ata
5 ato. Ashtu mu kujtohet. Mirëpo, [REDAKTUAR]

6 [REDAKTUAR]

7 [REDAKTUAR]

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Më
9 falni. Jemi në seancë publike edhe z. dëshmitar, ju rikujtoj
10 të mos i jepni hollësi të cilat mund të bëjnë që të
11 identifikoheni.

12 DËSHMITARI: Duhet, më fal, se përsëri kam harruar. Më
13 falni, shkëlqesia juaj, përsëri është faji im që s'e kam pasë
14 ndërmend.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk
16 është nevoja të kërkoni ndjesë, po thjesht ju kujtoj.

17 DËSHMITARI: Ato kujtimet e pastaj ka humbur ajo çështja
18 e privatësisë.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
20 kuptojmë plotësisht.

21 Z. Prokuror, vazhdoni ju lutem.

22 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

23 Py. Jemi akoma në seancë të hapur. Ty vetë a të keqtrajtuan
24 gjatë ndalimit në Zllash?

25 Pë. Po.

1 Py. A mund t' u tregoni Gjykatësve sesi ndodhi?

2 Pë. Po. Më morën në mbrëmje me vete. Më lidhën, nuk më
3 kujtohet, a më kanë mbyll sytë apo më kanë vënë një diçka mos
4 me pa ku po shkojna. Kur jena shku atje ma ka hjekë. Pa duar
5 të lidhuna pa kurr gjë, vetëm në përcjellje të dy personave
6 edhe dy kanë qenë anash tyre edhe thanë më hjek pjesën e
7 sipërme, me u zhvesh krejt. Domethënë, prej belit e lartë m' u
8 zhvesh krejt edhe pastaj më pyesnin thoshin "Pse ti ke marrë
9 shënime në atë bllokun që e ke?" Thashë "Kjo është lloj ditari
10 që kam pasë unë". Dhe kjo është e shënime me stilolaps - se
11 atëherë unë e kam shënue me stilolaps ditarin jo me kimik - në
12 mënyrë që vetëm me qit ujë në rast rreziku fshihet ajo, a po
13 kupton. Edhe i kam thënë qyshtu-qyshtu kam marrë shënime që me
14 e lexu s' janë kurr gjë. Diçka mu nuk më duket që janë të
15 palejueshme, kërrkush s' na ka thënë që janë të palejueshme
16 ditari me marrë me vete. "Jo" tha "ti po spiunon". "Jo" thashë
17 unë "S' kam të bëj kurrfarë. Nëse e ke ti ndonjë dokument,
18 provë që po spiunoj".

19 Edhe ka fillu tha "Përkulu". Domethënë, unë kam qenë në
20 këtë pozitë -- a me ju tregu pozicionin si kam qenë?

21 Kam qenë në këmbë edhe tha "Q' ështëu qëdro". Kështu kam
22 qëndru unë. Domethënë me rroba të hjekta dhe më kanë goditë në
23 shpinë edhe këtu. Domethënë prej kësaj pjese e te poshtë deri
24 qetu. Më kanë godit me një shufër të gomës, ishte sikur shufër
25 e milicisë serbe - jo policisë atëherë milicia u qujshin -

1 domethënë, shufër e tyne si duket ishte ajo. Shufër e gomës jo
2 shufër metalike, domethënë, shufër e gomës policore.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Më
4 falni. Më falni.

5 Z. Prokuror, kërkoj ndjesë.

6 Dua që të shtoj asaj që sapo tha dëshmitari, për të qenë
7 të qartë, se ne e shikojmë me sy po nuk mbetet me fjalë.

8 Ajo që pamë sy ishte që dëshmitari u përkul dhe i kishte
9 vënë duart në sup dhe po tregonte me gisht pjesët e sipërme të
10 supeve dhe pjesën e pasme të shpatullave ku tha se e kishin
11 goditur.

12 A e përshkrova saktë për të gjithë ne që jemi këtu që
13 pamë?

14 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Po. E nderuar Gjykatëse,
15 kështu mendoj.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
17 rregull. S'kam gjë tjetër. Kjo ishte për procesverbalin.

18 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]
19 Py. T'i kthehem dhe një herë pyetjes. A të kujtohet sa herë
20 të kanë goditur me këtë shkopin e gomës?

21 Pë. Vetëm atë natë.

22 Py. Jo, nuk e kisha fjalën sa herë të kanë rreh kur ishe në
23 Zllash, por sa herë të kanë godit atëherë në shpinë me këtë
24 shufrën?

25 Pë. Nja 10-12 herë ashtu, mos ma tepër.

1 Py. Kur ishe aty, tek ai vendi, a pe se mos ishte dikush si
2 komandant i atyre p.sh., mund ta kuptoje nëse dikush ju jepte
3 urdhra të tjerëve apo ndonjë udhëzim apo diçka t'u thoshte
4 diçka të tjerëve që ti ta kuptoje që ky ishte komandanti në
5 krahasim me të tjerët?

6 Pë. Jo, nuk kam vërejtë. Ndoshta ka pasë përreth, po unë nuk
7 kam vërejtë. Unë kam vërejtë dy persona ma të rinj se unë që
8 më merrnin në pyetje, shumë ma të rinj se unë në atë kohë,
9 dikun 17-18 vjet, paramendoje ti, edhe dy tjerë më të rritur
10 që rrinin anash tyre si sigurim në gjendje gatishmërie. Këta
11 persona gjithsej kanë qenë katër në atë vendin ku më kanë
12 marrë në pyetje dhe më kanë rrahur. Ndërsa ka pasë përreth
13 tyre, unë nuk kam vërejtë që ka pasë dikush, ndoshta dhe ka
14 pasë, unë nuk e di mirë.

15 Po më vonë, domethënë, mbasi që kam analizu gjërat, unë
16 kam vërejtur që m'u nuk ma merr mendja që ka qenë qëllimi ajo
17 i rrahjes time dhe i krijimit të asi lloj situatash për neve.
18 Po ka qenë kjo çështje më tepër e bindjeve tona çfarë i kemi
19 pasë politike, ushtarake, domethënë, shkakut i tyre. Sikurse që
20 i ka ndodhë shumë tjerëve. Unë mendoj që ajo ka qenë. Nuk ka
21 qenë çështje që ne kemi qenë spiunë fare, ajo s'ka pasë të bëj
22 me atë çështje fare hiç. Unë mendoj, domethënë, më vonë e kam
23 mendu këto jo për kohën që po më pyesin ju. Domethënë për atë
24 kohë unë kam mendu se ata mund të vepronin asisoj deri sa jam
25 bind vetë më vonë.

1 Py. Përmende se arsyeja e rrahjes edhe e marrjes në pyetje
2 ishte besimi yt politik, kështu sikur na the edhe nëse po,
3 mund të na tregosh më shumë për këtë?

4 Pë. Këtë e kam zbulu më vonë, domethënë, thashë. Se nuk ka
5 mund të jetë ajo për shkas se ne s'kemi qenë asnjë prej atyre
6 lloj çfarë -- s'ka pasë të bëj fare me atë çështje asnjëri
7 prej neve. Është fjala për ne tre që kemi qenë aty. Domethënë,
8 kjo ka pasë të bëjë drejtpërsëdrejti me çështje për shkak se
9 ata e kanë ditë që unë besoj në një pati politike që ata e
10 kanë pasë kundërshtare të gjithë. Edhe më vonë ka ndodhë dhe
11 vrasje të ndryshme për ato çështje dhe për ato bindje të
12 njerëzve të ndryshëm. Ka ndodhë edhe atentate të ndryshme të
13 dështume duke përfshirë dhe Presidentin Rugova, që dy herë i
14 kanë bërë atentat edhe ka shpëtuar. Ka dhe deputetë që tani janë
15 ende deputetë edhe janë në karrocë të invalidëve. Edhe m'u nuk
16 ma merr mendja që ka qenë ky shkak. Po të gjitha këto që janë
17 bërë janë bërë vetëm për shkak të bindjeve, ideve që nuk janë
18 përshtat me ide të tyre edhe me bindje tyre. Ashtu mendoj unë.

19 Py. Për të qenë i qartë: Nga e dinin këta, më saktë, nga e
20 dinin këta personat që të maltratuan, nga e dinin këta se
21 çfarë bindjesh politike kishe ti që s'u pëlqenin atyre?
22 Domethënë, nga e di -- si mendon?

23 Pë. Unë mendoj ashtu. Ndërsa a e dinin këta nuk e dinin, unë
24 nuk e di. Po unë dhashë mendimin çka ma vonë, domethënë, e kam
25 -- mendoj që është për atë arsye. Ndërsa se nga e dinin këta

1 duhet me i pyet përgjegjësit e tyre. Përgjegjësit e tyre duhet
2 me i pyet arsyen pse? Ata mund të japin arsye juve. Pastaj ju
3 mund të zbuloni vetë se ashtë q'ashtu a jo.

4 Po ashtu dihet ajo publikisht që sa kam lexu unë në
5 gazeta, tash nuk po flas çka di unë kështu, po në gazeta
6 shënon që [REDAKTUAR] ka qenë i dyshimtë për një vrasje të
7 këtij lloji edhe është liru në mungesë të fakteve. Në gazetë
8 kam lexu, jo që kam ndëgjju prej dikujna. E mujni me lexu edhe
9 vetë nëse hynë në Google shënon për ta edhe e shef. Kush është
10 ai, kush ai, krejt për secilin.

11 Py. A mendon se fakti që gjatë këtij takimi në odë, e ceke
12 ti, që është kryetari i UÇK-së ishte Ibrahim Rugova, mendon që
13 kjo pati ndonjë influencë në këtë fakt që më pasë ty të
14 ndaluan dhe të maltrajtuan?

15 Pë. Me siguri. Shumë mendoj ashtu. Jo komandanti i UÇK-së, po
16 ka qenë komandant i të gjitha Forcave të Armatosura të
17 Republikës së Kosovës, i të gjitha forcave, sa ka qenë gjallë.
18 Jo me fjalë goje, po ka qenë në aspektin kushtetues të asaj
19 kohe.

20 Py. T'i kthehemi atyre personave që po bënë këto pyetje dhe
21 që ju kanë keqtrajtuar. A e kanë thirrë njeri-tjetrin p.sh.,
22 me emër apo me grada në një mënyrë që ti mund të identifikojë
23 se kush ishin?

24 Pë. Jo, asnjëherë nuk kanë biseduar ata mes vetit për këto
25 çështje kur na kanë marrë në pyetje neve.

1 Py. Sa për ta sqaruar për transkriptin. Pra, ti nuk i ke
2 njohur ata persona që të kanë keqtrajtu edhe që të kanë marrë
3 në pyetje?

4 Pë. Po, s'i kam njohur unë.

5 Py. Na the që kjo marrje në pyetje dhe rrahja jote kanë
6 ndodhur vetëm një herë; a është e saktë?

7 Pë. E saktë.

8 Py. Sa ditë mbasi të kanë pru në ahur, në Zllash, ka ndodh
9 kjo marrja në pyetje dhe rrahja jote?

10 Pë. Njëherë thashë ka ndodhë. Ndërsa ne kemi qëndruar aty më
11 tepër se tri-katër ditë, një javë. Nuk më kujtohet saktë sa.

12 Po e di që më tepër se katër ditë ka ndodhë qëndrimi aty deri
13 një javë ashtu. Një javë, dhjetë s'jam i sigurt saktë sa ka
14 ndodhë, mirëpo, kjo është minimumi edhe maksimumi e thashë sa
15 kena mujt me qëndrue. Sa kemi qëndruar aty. Unë personalisht,
16 po flasë për veten.

17 Py. E kuptoj. Faleminderit për këtë sqarim për kohë zgjatjen
18 sa ke ndejtë aty.

19 Por pyetja ime ishte në cilën prej atyre katër deri në
20 shtatë ditë, në cilën prej atyre ditëve të kanë marrë edhe të
21 kanë marrë në pyetje dhe të kanë keqtrajtuar?

22 Pë. Ditën e tretë më duket. Më duket nuk jam i sigurt dytën-
23 tretën ashtu ka qenë ajo. Diku ka mesi i ditëve maksimale ka
24 qenë, se tani është problem me përcaktue saktë, domethënë, në
25 cilën ditë. Po e di diku në pjesën e parë apo në mesin e të

1 gjithë ditëve sa kam qenë në maksimum atje.

2 Py. Sa kohë ka zgjatë e gjithë marrja në pyetje dhe
3 keqtrajtimi? Në qoftë se të kujtohet. Sa kohë ka zgjatë?

4 Pë. Afërsisht ka zgjatë, mendoj, nuk di sa me thënë gjysëm
5 ore. 20 minuta, gjysëm ore jo ma tepër.

6 Py. Pra, 20 minuta, gjysëm ore total. Edhe marrja në pyetje
7 edhe rrahja kështu?

8 Pë. Po.

9 Py. Si përfundoi marrja në pyetje dhe rrahja?

10 Pë. Pas rrahjes më tha "të veshi ato ça i ke" dhe më dërguan,
11 më përcollën tek vendi ku qëndrojmë ne. Pastaj pas dy ditëve
12 as di sa mu thanë "Je i lirë. Shko në shpi".

13 Para meje kanë lirue një person tjetër. Atë që përmenda
14 më herët atë të gjatin që qe. Edhe pas meje ka mbetë ai më i
15 vjetri. Kur e kanë liru atë nuk e di.

16 Py. T'i kthehemi momentit kur po të merrnin në pyetje dhe po
17 të rrehnin. Nëse më kujtohet drejtë ju na thatë që ishin dy
18 persona që të kanë bë pyetje; a është e saktë kjo?

19 Pë. E saktë. Kanë qenë dy persona, dy anash edhe njëherë ja
20 ardh edhe dy femra kanë qenë. Mirëpo, ato nuk kanë marrë në
21 pyetje. Ato vetëm kanë qëndruar afër tyre.

22 Py. Pra, këta dy persona ju kanë bë pyetje. Kush ishin ata që
23 ju kanë rrahë? Të njëjtët persona që ju kanë bë pyetjet apo
24 personat tjerë?

25 Pë. Të njëjtët.

1 Py. Pra, të njëjtët persona që të kanë bërë pyetje edhe të kanë
2 rrahë; kështu?

3 Pë. Saktë.

4 Py. A i ke humb ndjenjat ndonjëherë gjatë kohës?

5 Pë. Asnjëherë.

6 Py. Kjo rrahje dhe kjo marrje në pyetje, a kanë ndodhur
7 përpara apo pas marrjes në pyetje të atyre dy personave tjerë
8 të ndaluar bashkë me ty?

9 Pë. Mbas.

10 Py. Viktima, të cilën ti e përshkrove që ishte rrahë keqas, a
11 e kanë sjellë atë në ahur para apo mbasi je keqtrajtu ti?

12 Pë. E kanë sjellë para.

13 Py. Nga momenti që je kthyer në ahur, mbasi të kanë
14 keqtrajtu, deri në momentin kur të kanë liru disa ditë më
15 vonë, a ka ndodhë ndonjë gjë tjetër e dhunshme ndaj teje apo
16 ndaj dy të ndaluarve tjerë që ishin me ty?

17 Pë. Jo, nuk po më kujtohem që ka ndodhë.

18 Py. A ke dijeni për ndonjë person tjetër që është mbajtur në
19 Zllash nga UÇK-ja brenda të njëjtit oborr atyne ndërtesave
20 gjatë kohës që ke qenë dhe ti atje?

21 Pë. Jo. Unë nuk kam qenë në dijeni që ka qendërmbajtëse aty,
22 gjeri sa më kanë dërgu vetë. Edhe nuk kam mujt, nuk kam pasë,
23 domethënë, nuk kam pasë dëgjuar nga ndonjë person apo ndonjë
24 informatë për ndonjë person tjetër. Ndoshta dhe ka pasë, po
25 unë nuk e di.

1 Py. Pak minuta më parë na the që në një moment të caktuar të
2 kanë liru. A mund të ti shpjegosh Gjykatës rrethanat e lirimit
3 tënd.

4 Pë. Rrethanat janë asisoj. Më kanë hap derën. E ka hap derën
5 një person ka thënë "Je i lirë. Eja pas neve". Jam dalë ka jam
6 hi brenda, mi ka dhënë gjërat ça i kam pasë të miat dhe i ka
7 ndalë thikën dhe atë notebookun, fletoren e vogël që i kam
8 shënimeve ditar, si lloj ditari kështu. Kjo ka qenë.

9 Edhe unë jam nisë në shtëpi në këmbë. Kam kalue nëpër male
10 asajt edhe jam shkue në shtëpi.

11 Edhe pastaj edhe njëherë jam kthye mbasandaj, po atëherë
12 kur jam kthy jam kthye ndryshe. Jam kthye i armatos deri në
13 dhëmbë kamë qenë dhe kam qenë me shumë tjerë. Kemi dërgu
14 furnizime ushtrisë atëherë kur jam shku herën e fundit.
15 Domethënë, kjo ka ndodhë mbas rrahjes. Domethënë mbasi që kanë
16 hyrë edhe ka fillu bombardimi i forcave të NATO-s në atë kohë.

17 Kam dërgue barna nga shtëpia e shëndetit tonë i kemi
18 tërhjek. Se ka aty forcat serbe e kanë djegë shtëpinë e
19 shëndetit. Ne e kemi fikë e kemi tërheq barnat ça kanë mbetë
20 aty dhe i kemi dërgue në Zllash. [REDAKTUAR]

21 [REDAKTUAR]

22 [REDAKTUAR]

23 [REDAKTUAR]

24 [REDAKTUAR]

25 [REDAKTUAR]

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W04669 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493
Pyetje nga z. Michalczuk Faqe 76
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 [REDAKTUAR]

2 atina i kemi dhënë ndihmën edhe ka qenë bashkë me neve deri
3 atje. Për shkak se ka pasë një doktor atje edhe s'e kam pasë
4 problem unë me e marrë se kam qenë i armatos dhe qatë ditë,
5 qatë armë që e kam pasë sa e kam shfrytëzue në vendin tim e
6 kam dorëzue se s'ka qenë e imja ajo. E ka lënë një ushtar
7 tjetër në shtëpinë time, që dihet kush është ai me emër
8 mbiemër dhe çfarë arme kam pasë edhe të gjitha.

9 E në atë kohë kur jam kthyer herën e fundit, ka qenë
10 [REDAKTUAR] komandant. Herën e fundit domethënë kur aty s'ka
11 pasë kurrfarë problemi me kërrkënd.

12 Kjo ka qenë e tërë, domethënë, ajo.

13 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] A mund të hyjmë në seancë
14 private shumë shkurtimisht.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
16 Sekretare, në seancë private ju lutem.

17 ~~{Seancë private}~~ [Seancë e hapur]

18 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë
19 private.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
21 Prokuror.

22 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] E vetmja arsye që kemi hyrë në
23 seancë private është referenca që u përmend vendi me emrin

24 [REDAKTUAR] që mund të identifikojë njerëzit që banojnë aty.

25 Është një incident i vogël që [REDAKTUAR] aty.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W04669 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493
Pyetje nga z. Michalczuk Faqe 77
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 Pra, për ta mbrojtur dëshmitarin ta bëjmë këtë.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E
3 kam dërguar mesazhin për redaktimin e kësaj pjese. Shoh që
4 është ngritur Mbrojtësja e Viktimave.

5 ZNJ. PUES: [Përkthim] Këto redaktime duhet të përfshijnë
6 edhe kur thuhet [REDAKTUAR], pra, i gjithë pasazhi që
7 është në fund të faqes 27 [REDAKTUAR]
8 [REDAKTUAR] Janë të gjitha të lidhura së bashku.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po do
10 të kujdesemi për këtë do të shikojmë urdhrin për redaktimin e
11 materialit dhe se çfarë do të përfshihet aty. Dhe do të vendos
12 se çfarë do të përfshihet në të.

13 ZNJ. PUES: [Përkthim] Një diçka që nuk ka lidhje me
14 redaktimet në vetvete, por meqë e kemi këtë ndërprerje të
15 vogël dhe nuk desha të ndërpres pak më herët.

16 A mund të shikojmë pasazhin e shkurtër ku u përshkrua
17 sesi dëshmitari u përkul sepse bashkëmbrojtësja më tha që ai
18 mbante duart në fund të shpinës dhe përdori një dorë për të
19 treguar shpatullën, për të treguar pozicionin sesi kishte
20 qëndruar sepse ka një element të vogël të përshkrimit që
21 mungon nga ajo që kemi në transkript. Dhe nëse kjo plotësohet
22 do të ishte shumë mirë.

23 Siç e thashë nuk desha të ndërpres pyetjet e Prokurorit
24 pak më herët, kur u bënë këto pyetje, prandaj edhe shfrytëzova
25 momentin e parë të mundshëm për t'i bërë këto vërejtje.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W04669 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493
Pyetje nga z. Michalczuk Faqe 78
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

2 Atëherë [ajo] çfarë do të bëj Mbrojtëse e Viktimave, do ta
3 shikoj gjatë pushimit nëse është i plotë përshkrimi dhe në
4 qoftë se jo dhe është e nevojshme do t'i kthehemi përsëri.

5 Pra, në qoftë se janë fjalët që janë duart e lidhura
6 mbrapa shpinës, atëherë do t'i shtojmë do t'i kthehemi përsëri
7 kësaj çështje.

8 Z. Prokuror, doni të qëndrojmë në seancë private apo mund
9 të hyjmë në seancë publike të hapur?

10 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Mund të hyjmë në seancë të
11 hapur.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
13 Sekretare, seancë publike.

14 [Seancë e hapur]

15 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë
16 publike.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
18 Prokuror, mund të vazhdoni.

19 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

20 Py. Z. Dëshmitar, para pak minutash po diskutonim çështjen e
21 lirimi tuaj nga Zllashi dhe desha t'ju bëj disa pyetje vijuese
22 në lidhje me këtë.

23 Dhe pyetja e parë që dua t'ju bëj: Kush ishte personi që
24 hapi derën e ahurit dhe ju liroi?

25 Pë. Nuk e kam njohur. Mendoj që roja që është aty. I panjohur

1 për mua është ai, ai person.

2 Py. A ishte ai në prej personave që të ka marrë në pyetje apo
3 që të ka keqtrajtuar apo që ishte i pranishëm gjatë marrjes në
4 pyetje dhe keqtrajtimit apo ishte person krejt tjetër?

5 Pë. Nuk e di. Mund të ketë qenë i pranishëm gjatë marrjes në
6 pyetje ndonjë që ka pasë qenë, po ai i fundit që mi ka dhënë
7 gjërat ka qenë ai që kam hy. Domethënë, roja që është aty.

8 Ndërsa personi që më ka dhënë lajmin që je i lirë, vazhdo, nuk
9 më kujtohet kush është. Nuk e di kush ka qenë. Nuk më
10 kujtohet. Nuk e njof.

11 Py. Si ishte i veshur ai person?

12 Pë. Ishte me rroba të zeza.

13 Py. A kishte ndonjë shenjë apo emblemë në uniformë?

14 Pë. S'më kujtohet për shkak se disa kanë pasë, disa nuk kanë
15 pasë. Nuk më kujtohet a ka pasë a jo në atë moment.

16 Py. Ishte i armatosur?

17 Pë. Jo, nuk e kam vërejtë.

18 Py. Kur të ka liru, a të ka thirrë emrin apo ka përdorur
19 fjalë tjera dhe nëse ka përdorur fjalë tjera çfarë fjalësh
20 ishin?

21 Pë. Nuk më kujtohet si më ka thirr, a ka thirr në emër a jo.
22 Vetëm e di që më ka njoftue që "Je i lirë". Nuk më kujtohet si
23 më ka thirr. Ata e kanë pasë emrin tim. Me siguri me emër më
24 kanë thirre, po nuk më kujtohet mu.

25 Py. Ai person që të ka liruar prej ahurit apo ndonjë person

1 tjetër që ishte aty në Zllash gjatë kohës që ke qenë ti aty, a
2 të ka dhënë ndonjë dokument lirimi?

3 Pë. Jo, jo. As kanë marrë shënime gjatë marrjes në pyetje, as
4 më kanë dhënë kurrfarë dokument lirimi.

5 Py. Gjatë asaj kohe që ke qenë në Zllash, a të ka dhënë
6 ndokush ndonjë dokument ku tregohej se mbi ç'baza të kishin
7 arrestuar ndaluar në Zllash apo s'të ka dhënë askush ndonjë
8 dokument të tillë?

9 Pë. As e kanë diskutu çështjen time asnjëherë kurrkush.

10 Py. Z. dëshmitar, a ke dijeni për ndonjë ofensivë serbe që ka
11 ndodhë gjatë ose afër kohës kur je liruar ti?

12 Pë. Po.

13 Py. Çfarë lloj ofensive ishte ajo? Datat?

14 Pë. Kur kam shku me dërgu barnat, së bashku me personat që
15 përmenda ma herët, ata dy. Tashi nëse është seanca e hapur nuk
16 po e tregoj, domethënë, dihet kush janë. Ka qenë duke u
17 zhvillue disa aksione. Ishin duke qenë, duke u zhvillu mes
18 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës pjesëtarëve dhe forcave serbe,
19 ku forcat serbe kanë gjuajtur me minahedhësa tokës të vegjël
20 quhen ato edhe minat e tyne kanë rënë afër rreth 20 afër meje.
21 Në një shtëpi, si lloj -- edhe ajo kishte qenë si lloj, si me
22 thanë, si lloj si plimi kështu e kashtës a din dhe e ka shemb
23 komplet atë kulmin e sajna. Po ashtu dhe dy predha tjera kanë
24 rënë në mal aty afër. Dhe [REDAKTUAR] ka qenë duke fol me
25 dikën në atë kohë dhe as që ka lëviz fare, si ka interesu për

1 ato dhe pse kanë rënë afër atyne, afër neve, domethënë, nuk
2 është frikësu fare prej atyre.

3 Këto janë që kam pa vetë me sytë e mi domethënë. Ka pasë
4 edhe hedhje tjera që janë gjuajte për shkak se ato kur
5 gjuajshin forcat serbe ato u ndëgjoishin një lloj fishkëllimi
6 krijojshin gjatë shkumjes në ajër edhe pastaj bijshin te
7 poshtë. Domethënë, ato kanë shku lart edhe janë kthy te poshtë
8 në pikën ku ata kanë mendue për me gju.

9 Py. Sa ditë mbasi je liru?

10 Pë. Vallaj është, tashti me thënë, është goxha moti se ajo
11 është pasë -- ajo ka qenë kësisoj ka qenë ajo. Kur ka ardh
12 ofensiva serbe në fshatin tonë unë kam qenë liruar atëherë.
13 Lirimi im në kohën kur kanë ardh ushtarët e forcave serbe në
14 fshatin tonë ka qenë maksimum tri-katër ditë ma vonë.
15 Domethënë, jam liru mbas tri-katër ditësh janë ardh forcat
16 serbe në fshatin tim.

17 Edhe m'u më kanë ndalë, për shkak se unë shkova në rrugë
18 kryesore kesh [REDAKTUAR] im aty edhe duke dalë në rrugë
19 kryesore i pashë duke u zhdjerrur mali, duke u lëshu malit te
20 poshtë disa ushtarë. Mendova që janë ushtarët tonë, se i pasë
21 vetëm të uniformum. Kur i kam pa që kanë shqiponjën e bardhë
22 në krahë e kam vërejtë që kanë qenë forca serbe.

23 Edhe jam kthye për me u kthy [REDAKTUAR]. Dikush
24 prej ushtarëve serb ka bërtit "Stani pucaçu" [fonetikisht]
25 edhe ka gjuajtur në drejtim timin. [REDAKTUAR]

1 [REDAKTUAR] Predha e plumbit që
2 ka shtënë ata serbët. Ata me siguri nuk dashë me më mbytë apo
3 kanë dashë me më tut apo diçka. Edhe jam kthy te ta edhe jam
4 kthy unë pastaj me të njëjtën hap edhe kam pa një ushtar ma të
5 gjatë se unë dy metra ka qenë me një shall të kuqe të vendosur
6 kështu lidhur në kokë edhe secili prej tyre ka pasë nga një
7 thikë jo në bel, po qetu. Edhe ato thikat nuk kanë qenë dy
8 tehëshe, po një teh. Secili e ka pasë të njëjtë.

9 Edhe më pyeti tha "Ku pate me shkue?" Në vend që me thënë
10 në gjuhë tyre serbisht me mshel dyrët i kam thënë mi çel. Edhe
11 pas asajna tha "Me kë je?". [REDAKTUAR]

12 [REDAKTUAR]

13 [REDAKTUAR]

14 [REDAKTUAR]

15 [REDAKTUAR]

16 [REDAKTUAR]

17 [REDAKTUAR]

18 [REDAKTUAR] kanë qenë [REDAKTUAR]

19 [REDAKTUAR]

20 [REDAKTUAR] kanë qenë të shtrirë në gjunjë në trotuar e me duar
21 pas kokës kështu të dytë. Njeri ka qenë me flokë të gjata deri
22 qetu, ka qenë mashkull domethënë, të dytë kanë qenë meshkuj.
23 Dhe ata i kanë ekzekutue.

24 Mbasi që jena shku na, babai im mbas tri ditë u kthye
25 prej Prishtinës, se na në Prishtinë kemi shku. Mund të tregoj

1 dhe vendet ku kemi qëndru. Kam qëndru tek daja im, kam qëndru
2 pastaj tek një mik apo është i afërmi jonë në tjetër vend në
3 dy vende dhe vendi i tretë kam qëndru afër, si është ai
4 stadiumi, tash shtëpia e shëndetit te bunara e Aratit. Edhe
5 prej aty, ajo ka qenë mbas nja dhjetë dite, jam kthye unë në
6 fshat timin. Edhe ka jam kthi më kanë gjujt forcat serbe dy
7 herë. Njëherë më kanë gjujz [REDAKTUAR]
8 [REDAKTUAR]
9 [REDAKTUAR]
10 [REDAKTUAR]
11 [REDAKTUAR] i kam vërejtë se ka qenë mali i premë. Prej
12 majës së malit i kam vërejtë. Mirëpo fati, rrezet e diellit i
13 kam vërejt që kanë reflektue dylbia e snajperit tina edhe kur
14 e kam pa unë malin e premë, aty kanë mujt me më likujdue prej
15 atij vendi. Po fati që e kam vërejt rrezet e diellit në dylbi
16 tina dhe i kam kalue malin e prerë krejt zhagas deri sa kam
17 dalë në mal të hapur, kështu që, nuk ka qenë i prerë. E tek që
18 atëherë, mbas eventualisht i bjen në dy jave, unë kam shkue
19 herën e tretë që përmenda atje.
20 Mirëpo derisa kam shku atje kanë ardhë plot forca, plot
21 njerëz të ndryshëm në shtëpinë time, për shkak se shtëpia ime
22 ka qenë në pozita strategjike që asisoj që të gjithë njerëzit
23 për me shku në Prishtinë --
24 Py. Do të flasim për këtë pak më vonë.

25 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Por a mund të hyj seancë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W04669 (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493
Pyetje nga z. Michalczuk Faqe 84
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 private për një moment?

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Sekretare, a mund të hyjmë në Seancë private?

4 ~~[Seancë private]~~ [Seancë e hapur]

5 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë

6 private.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

8 Prokuror, mund të them që kam dërguar dy propozime për
9 redaktime në lidhje me [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR]. Pra, ka
10 diçka tjetër që deshët me shtu në lidhje me këtë.

11 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Jo, vetëm për këtë e bëra
12 ndërhyrjen.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dhe e
14 shof dhe Mbrojtësja e Viktimave po tund kokën në shenjë
15 pohimi.

16 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Dëshmitari përmendi emra është
17 mirë që të shifet i gjithë konteksti.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo
19 vetëm emrat por desha të të them që ne i kemi vënë re këto dhe
20 do t'i redaktojmë.

21 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Faleminderit.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po i
23 afrohem orës 13.00, kështu që do të kërkojë që hyjmë në
24 seancë publike dhe ta mbyllim këtë seancë.

25 Zonja Sekretare, a mund të hyjmë në seancë publike?

1 [Seancë e hapur]

2 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë

3 publike.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

5 Faleminderit.

6 Z. Prokuror, po shkon ora 13.00. A mund të na thoni se

7 kur do të jetë një kohë e përshtatshme për të bërë pushimin,

8 apo nëse doni të bëni dhe nja dy pyetje për ta përfunduar këtë

9 linjë të pyetjeve?

10 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Momenti më i përshtatshëm

11 është tani për ta mbyllur.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

13 Faleminderit.

14 Z. dëshmitar, do të bëjmë një pushim një orë e gjysëm

15 deri në orën 14.30. Pra, bëni pak pushim dhe do t'ju shohim

16 përsëri, do të vini përsëri këtu në orën 14.30.

17 DËSHMITARI: Faleminderit, shkëlqesia juaaj.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po

19 shikoj që zonja shoqëruese po është, gjendet aty.

20 Faleminderit.

21 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në

23 rregull. Tani bëjmë pushimin. Do të rifillojmë në orën 14.30.

24 Ndërpresim seancën këtu.

25 --- Pauza e drekës fillon në orën 13.00

1 --- Seanca rifillon në orën 14.32

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
3 se jeni rikthyer. Të shohim kush janë të pranishëm. ZPS-janë
4 është thuajse me të njëjtën përbërje.

5 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Vërtetë të nderuar Gjykatës,
6 jemi thuajse me të njëjtën përbërje. Për seancën e pas drekës,
7 z. Filippo De Minicis, Zëvendës Prokuror nuk do të jetë i
8 pranishëm.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë,
10 faleminderit. Mbrojtësja e Viktimave shoh që keni të njëjtën
11 përbërje, shoh që pohoni me kokë.

12 Në rregull. E njëjta vlen edhe për ekipin e Mbrojtjes.
13 Dhe e shoh që z. Mustafa është i pranishëm përmes
14 videolidhjes.

15 Në rregull atëherë. I lutem asistentes së sallës që të
16 shoqërojë dëshmitarin për të hyrë në sallë.

17 [Dëshmitari vijon dëshminë]

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
19 dëshmitar, mirë se jeni rikthyer.

20 Mirë se u rikthyet z. dëshmitar.

21 DËSHMITARI: [Përkthim] Mirë se ju gjej, faleminderit.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ia
23 jap fjalën Zyrës së Prokurorit të Specializuar për të vazhduar
24 me bërjen e pyetjeve të Dëshmitarit W04669. Z. Prokuror, keni
25 edhe 2 orë e 27 minuta që ju kanë mbetur nga koha në

1 dispozicion.

2 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Me sigurinë më të lartë mund
3 t'ju them se s'do ta përdor të gjithë këtë kohë. Me shumë
4 gjasë do të më duhet edhe gjysmë ore deri në një orë.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
6 Faleminderit, keni fjalën.

7 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]
8 Py. Z. Dëshmitar, dua që t'i kthehemi asaj që po diskutonim
9 përpara pushimit se kam nevojë për një sqarim, por për ta bërë
10 këtë gjë, do të më duhet që në ekran të nxjerrë një pjesë të
11 deklaratës suaj, të cilën ja keni dhënë Zyrës së Prokurorit të
12 Specializuar.

13 Znj. Sekretare, ju lutem nëse mund të nxirrni në ekran
14 dokumentin me numër 082023-TR-ET, Pjesa 2, RED1. Është
15 deklarata e redaktuar. Nëse është e mundshme dëshiroj që të
16 kalojmë të shohim rreshtin 7, në faqen 14, rreshtat nga 7 deri
17 në 14, përfshirë dhe 14.

18 Py. Z. dëshmitar, jo është vetëm në anglisht, por do të lexoj
19 dhe do të përkthehet në shqip sigurisht me zë në dëgjuese. Së
20 pari, ta lexoj dhe pastaj të bëj një pyetje.

21 Pyetja po bëhej nga Prokurori:

22 "Në lidhje me këta dy personat, të cilët ishin aty me ty,
23 a i ke parë që të maltrajtoheshin"?

24 Ti je përgjigjur: "Jo, jo, po më thanë, më tregun".

25 Pastaj Prokurori të ka pyet, të ka bërë këtë pyetje:

1 "Po a dëgjove diçka që nga e cila ti të kuptoje se ata po
2 maltrajtoheshin fizikisht"?

3 Dhe ti je përgjigjur: "Po, po, janë kam bërë "au" kur i
4 kanë goditë".

5 Prokurori të ka thënë: "Më fal, çfarë, çfarë bënë këta"?

6 Dhe përgjigjja jote, siç është shpjeguar nga përkthyesi
7 atëherë: "Au është një "aj". D.m.th. aj ja bëjnë ata kur i
8 godasin, kur i godet dikush domethënë".

9 Pyetja që kam tani është kjo: Sot na the se nuk i
10 dëgjove. Nuk i dëgjove që t'i kishin maltrajtuar këta dy të
11 ndaluar, por ama këtu në këtë deklaratë, të cilën sapo ta
12 lexova, të cilën deklaratë ia ke dhënë Prokurorit, qartë ke
13 thënë se i ke ndigju që kanë lëshu këtë tingull kur i kanë
14 goditë. Pra për të qenë të qartë, a i dëgjove apo nuk i
15 dëgjove këta dy persona kur i maltrajtojshin? A dëgjove ndonjë
16 zë, ndonjë diçka, a u doli atyre ndonjë zë kur po
17 maltrajtoheshin?

18 Pë. Koha kur është dhënë deklarata më herët, për dallim prej
19 kësaj, d.m.th. mbamendja ime, ça kam mbajt mend mund të ketë
20 qenë asisoj siç është shënu më herët. Mirëpo në momentin kur
21 ju keni pyetur, mu nuk më është kujtuar ajo. Mund të ketë qenë
22 që të kem dëgjuar ndonjë klithmë të ndonjë prej tyre, por nuk
23 më kujtohet.

24 Nuk di a jam i qartë, d.m.th. koha, ka kalu një kohë e
25 gjatë edhe mund të ketë qenë që kam dëgjuar ndonjërin prej

1 tyre, po ajo ka qenë si lloj, nuk ka qenë ajo në atë aspektin
2 që ka mbetur në mbamendjen time ende, a kupton, më ka ikur.

3 Kjo është ajo që mund të them.

4 Py. Pa problem. Është e qartë. Të falënderoj shumë për këtë
5 shpjegim.

6 T'i kthehem tani kohës, momentit rreth të cilit të kanë
7 liru prej Zllashit dhe mesa më kujtohet the se u lirua një
8 person nga ai ahuri përpara teje. Pastaj personi tjetër
9 qëndroi në ahur pasi të liruan ty. Është e saktë kjo?

10 Pë. Ashtu më kujtohet.

11 Py. Mbase a e di se çfarë i ndodhi atij njeriut që mbeti aty
12 në ahur mbasi të liruan ty?

13 Pë. Nuk e di. Vetëm atë kam parë pas disa viteve edhe më ka
14 pyetur se dy herë jemi takuar me të. Dy herë më ka pyetur se a
15 do të vazhdojmë të tregojmë këtë çka ka ndodhur. Çka na ka
16 ndodhur neve është fjala. I kam thonë që ende nuk është koha
17 edhe nuk është koha edhe nuk është vendi. Edhe ai e ka kuptuar
18 atë sepse.

19 Py. Pse i the ti që nuk ishte koha? Momenti i duhur pra për
20 të raportuar, për të kallëzuar për këto gjëra që kishin
21 ndodhur në Zllash?

22 Pë. Për shkak se i thashë atij se, "Nëse raporton tani ato,
23 ata i kanë të gjithë institucionet nën mbikëqyrje të vet".

24 Py. Këto institucione gjithashtu mbaheshin nga "këta njerëz".

25 Kush janë "këta njerëz"? Në ç'kuptim?

1 Pë. Nuk di këta njerëz, po problemi është që unë i kam thënë
2 që nuk është koha. Për mu nuk ka qenë koha dhe ashtu e kam
3 dhënë mendimin unë për të. Edhe ai a ka vazhdu, a e ka dhënë a
4 s'e ka dhënë, nuk e di unë. Unë i kam thënë ashtu.

5 Py. Pyetja ime e fundit është për këta personat, "ata
6 personat", kush janë "ata personat"? Për kë e ke fjalën?

7 Pë. Se kam fjalën për kurrkënd. Ai ka pyetur se a e paraqesim
8 rastin tonë në organet policore apo gjykatë apo prokurori. Unë
9 i kam thënë se, jo, nuk është koha. Kjo është përgjigjja ime
10 për këtë çështje.

11 Pë. Po, po të kujtoj. Por the, mund ta citoj faktikisht nga
12 transkripti sot. The që ky nuk ishte, "kjo nuk ishte koha e
13 duhur, sepse në këto institucione ishin këta persona, i mbanin
14 këta persona".

15 Kush ishin?

16 Pë. Nuk i mbanin këta persona, por nuk është institucionet e
17 besueshme në atë aspektin që kanë me... Unë nuk i kam besuar
18 institucionet e atëhershme. Kjo ka qenë ajo që me ta shtjellu
19 qartshëm për vete. Unë nuk kam besu në ato.

20 Py. Kur ndodhi ky takim apo këto takime? Të kujtohet viti të
21 paktën?

22 Pë. Po, për afërsisht nuk më kujtohet, po ka qenë dikur mbas
23 disa viteve, është fjala në 2006 e tutje.

24 Py. Ky personi a të tregoi për rrethanat si e kishin liruar
25 nga Zllashi?

1 Pë. Më kujtohet, vetëm më ka thënë, më kanë liruar menjëherë
2 mbas teje. Nuk e kam pyetur as për kohën as kurrëgjë. E di që e
3 kam marrë në shënime emrin, mbiemrin e tij, numrin e telefonit
4 edhe i kam thonë që do të jemi në kontakt. Kjo është e tëra.

5 Edhe tani ata, emrin, mbiemrin e tij dhe numrin e
6 telefonit nuk e kam, për shkak se e kam pasë në një telefon
7 tjetër ose e kam diku në fletore të shënimeve zyrtare që mbaj
8 por nuk kam mundur ta gjej ende. Mirëpo personin e njof me e
9 pa. Edhe mund ta gjej në bazë të atyre që ju kam tregu juve
10 d.m.th. [REDAKTUAR]si ushtarë të

11 UÇK-së. Ka qenë i ndaluar së bashku me neve për shkak të një
12 arme që ia kanë marrë ata edhe kjo është.

13 Py. Për t'ju kthyer, për t'ju kthyer kohës në Zllash kam disa
14 pyetje shumë të përgjithshme. Gjatë qëndrimit në Zllash,
15 d.m.th. kur ishe i ndaluar aty, a more kujdes mjekësor?

16 Pë. Jo, nuk kam kërkuar, as nuk kam marrë.

17 Py. Gjatë kohës së ndalimit tënd në Zllash, a pate mundësi të
18 mbaje lidhjet me familjen apo me persona të tjerë jashtë?

19 Pë. Jo, personit para meje që ka dalë, i kam thonë me njoftue
20 një djalit hallës që ishte në një fshat - mbasi është kjo e
21 hapur nuk përmendi - me i tregue që jam i ndalum atje. Personi
22 që u liru para meje. Edhe i kam tregu cilit me i tregu. A i ka
23 tregu as s'i ka tregu, nuk e di.

24 Py. Emri nuk është i nevojshëm, të paktën hë për hë. The se
25 lidhjen me familjen nuk ta krijuan gjatë asaj kohe. Nuk t'u

1 dha mundësia që të kontaktoje persona të tjerë jashtë. Po këta
2 dy të ndaluarit e tjerë, të cilët ishin në të njëjtin vend të
3 ndaluar me ty, ata kishin mundësi të qëndronin në lidhje me
4 familjen, pra të kontaktonin familjen. A kishin mundësi të
5 kontaktonin dhe të tjerë jashtë?

6 Pë. Si mendoni ju me pasë kontakt jashtë. Atëherë nuk ka pasë
7 mjete komunikimi, vetëm fizikisht, nëse ka ardhë dikush. Po
8 nuk ka ardhë askush as për atë as për neve.

9 Py. Z. dëshmitar, gjatë kohës që ke qenë aty në Zllash,
10 psikologjikisht si ndiheshe, mund tua thuash gjyqtarëve?

11 Pë. Po, unë tregova. Fillimisht mu ka duk shumë e palogjikshme
12 arsyeja pse më kanë dërgu atje. Edhe pastaj ka fillu ai
13 rreziku kur e kemi vërejt ne viktimën që e kanë pru tek ne në
14 atë gjendje edhe menjëherë mendja ka shkuar pastaj e kam
15 realizuar pse e kanë pru ata arsyen d.m.th. dhe menjëherë mu
16 ka shfaqë rreziku në mendje që mund të na gjejë të gjithëve
17 njësoj.

18 Py. E kuptoj. Ahuri ku ju mbanin, a ishte i kyçur me çelës?

19 Pë. Po. Edhe i ruajtur nga rojet, hyrjet.

20 Py. Çfarë lëndimesh pësove ti për shkak të gjërave që të
21 ndodhën në Zllash? Unë kur jam kthy në shpi për me u pastru, e
22 kam pa që në shpinë edhe duke filluar edhe në supe këtu i kam
23 pasur krejt zi vendet ku më kanë goditur. I kam pasë të
24 mavijosura në të zezë edhe ato më kanë qëndruar rreth katër-
25 pesë ditë ashtu. Ndoshta edhe më tepër se nuk i kam kushtu

1 mendje.

2 Py. A ju drejtove ndonjë personeli mjekësor për t'u trajtu

3 pasi të lirun nga Zllashi?

4 Pë. Jo.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

6 Prokuror, për sqarim, dëshmitari vuri dorën në supin e majtë,

7 në pjesën e sipërme kur po tregonte se ku e ndjente atë

8 lëndimin. Nuk shoh kundërshtim nga palët edhe nga të

9 pranishmit e tjerë. Kështu që ta vendosim në procesverbal

10 kështu.

11 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Një pyetje për ta sqaruar këtë,

12 me lejen tuaj të nderuar Gjykatës.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

14 Patjetër.

15 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

16 Py. Kur e kontrolllove trupin, a e pe në ishte i zi a ishte i

17 zi vetëm këtu apo - a mund t'ia përshkruash Gjykatësve se ku

18 ishin këto shenja të zeza?

19 Py. Nëse kjo është pasqyrë, unë kur jam pastruar e kam pasë

20 pasqyrën në banjo edhe kur jam kthyer në këtë pozitë, e kam

21 vërejt si dukej. A po e vëreni kështu? Kaq ka qenë domethënë.

22 S'i kam tregu as nënës, as vëllezërve, as kurrkujt.

23 Py. Faleminderit për këtë shpjegim, po pyetjen që desha të

24 bëj e kisha në ç'pjesë të shpinës e kishe të nxirë? Ku në

25 ç'pjesë të shpinës?

1 Pë. Shpinën.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

3 dëshmitar

4 DËSHMITARI: D.m.th. kam shpinën komplet.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

6 dëshmitar, ju lutem prisni derisa të përfundojë pyetjen

7 Prokurori apo atë që po thotë, pastaj përgjigjuni se për ne

8 është e pamundur që të kuptojmë atë që thoni ju nëse flasin në

9 të njëjtën kohë dy persona, sepse nuk mund që të vendoset dhe

10 përkthimi në atë rast. Ju lutem prisni derisa të mbarojë

11 Prokurori.

12 Vazhdoni z. Prokuror.

13 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Një sekondë, e nderuara

14 Gjykatëse.

15 [Prokurori i Specializuar këshillohet]

16 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, dua që t'i

17 tregoj dëshmitarit një fotografi. Do të doja që të vazhdojmë

18 të qëndrojmë në seancë të hapur, por do t'ju lutesha shumë që

19 fotografia të mos transmetohet publikisht. Ta shikojë vetëm

20 dëshmitari dhe personat e tjerë të pranishëm në sallë. E kam

21 fjalën për fotografinë me numër 082020-0802023, faqja 3.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: Z. Prokuror, unë

23 mesa di edhe kur jemi në seancë të hapur, ekrani i provave nuk

24 është i dukshëm publikisht.

25 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Unë për këtë po kërkoja.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,
2 po kështu është zakonisht. Kështu bëhet procesi.

3 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Faleminderit që ma rikujtuat.
4 Py. Z. dëshmitar, a e sheh fotografinë në ekran tani?

5 Pë. Po.

6 Py. A e sheh nënshkrimin, firmën poshtë, në pjesën e poshtme
7 të fotografisë?

8 Pë. Po.

9 Py. Firmë e kujt është ajo?

10 Pë. E imja.

11 Py. Gjykatësve a mund t'i thoni se çfarë tregoj kjo
12 fotografi.

13 Pë. Kjo tregon ku kemi qëndruar ne.

14 Py. Z. dëshmitar me një rreth ngjyrë të kaltër të errët, blu
15 të errët është qarkuar, janë qarkuar dy ndërtesa. Këtë rreth,
16 këtë qark e keni vizatu ju vetë?

